



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Gusht, 2017r.

Nr. 8/2017

Ambasadori i Britanisë Çarls Gareth në vizitë pune të Agjencisë



Përfaqësues të Agjencisë gjatë muajit gusht kishin takim pune me ambasadorin e Britanisë së Madhe në Maqedoni, Çarls Gareth. Në takim u bisedua për monitorimin e shërbimeve të radios dhe televizionit gjatë Zgjedhjeve Lokale 2017, mënyra e informimit të medimeve si dhe raportet e monitorimit, që i përpilon Agjencia.

Reagimet e Agjencisë – Dënohen incidentet ndaj ekipeve të gazetarëve të portalit Kurid.mk dhe Nova TV

Agjencia gjatë gushtit reagoi dhe e dënoi incidentin me heqjen e kameramanit të internet portalit kurir.mk gjatë seancës publike të Komisionit shtetëror zgjedhor dhe apeloj që të mundësohet punë e drejtë dhe pa pengesa për punëtorët mediatik në mënyrë që të informojnë për të gjitha ngjarjet.

Agjencia e dënoi edhe sulmin ndaj ekipit të portalit Nova TV, i cili ndodhi në komunën e Aerodromit, gjatë mbulimit të organizimit të iniciativës civile për mbledhje të nënshkrimeve kundër ndërtimit të kampeve për refugjatë dhe apeloj që të respektohet dinjiteti i profesionit të gazetarit si dhe të mos pengohen punëtorët mediatik gjatë realizimit të detyrës së tyre profesionale.

Analiza e procedurave të inicuar kundër radiodifuzerëve gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016


Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale përpiloi një Analizë të procedurave të inicuar për kundërvajtje kundër radiodifuzerëve gjatë Zgjedhjeve të parakohshme për deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, për shkelje të dispozitave të Kodit zgjedhor. Qëllimi i analizës është shqyrteimi i rezultateve nga procedurat e inicuar kundërvajtëse, identifikimi i faktorëve që ndikonin në miratimin e vendimeve gjyqësore, si dhe dhënies së rekomandimeve me qëllim të përmirësimit të rregullativës zgjedhore.

Në Analizë janë përfshirë procedurat për kundërvajtje gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të planifikuara që të mbahen më 24 prill 2016. (që nuk u realizuan), si dhe procedurat e kundërvajtjes gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, që u realizuan më 11 dhjetor 2016.

Analiza e strukturës së të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2016.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale përpiloi një Analizë të procedurave të inicuar për kundërvajtje kundër radiodifuzerëve gjatë Zgjedhjeve të parakohshme për deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, për shkelje të dispozitave të Kodit zgjedhor. Qëllimi i analizës është shqyrteimi i rezultateve nga procedurat e inicuar kundërvajtëse, identifikimi i faktorëve që ndikonin në miratimin e vendimeve gjyqësore, si dhe dhënies së rekomandimeve me qëllim të përmirësimit të rregullativës zgjedhore.

Në Analizë janë përfshirë procedurat për kundërvajtje gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të planifikuara që të mbahen më 24 prill 2016. (që nuk u realizuan), si dhe procedurat e kundërvajtjes gjatë Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, që u realizuan më 11 dhjetor 2016.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

ZGJEDHJET LOKALE 2017.

Pas shpalljes së Zgjedhjeve lokale nga ana e Kuvendit të RM-së, Agjencia në pajtim me Kodin zgjedhor, filloi me monitorimin e informimit të radiodifuzerëve për Zgjedhjet lokale 2017. U dërgua shkresë deri te të gjithë radiodifuzerët, në të cilën në mënyrë precize u informuan lidhur me obligimet e Kodit zgjedhor, të cilit duhet t'i përmbahen deri në fillimin e fushatës zgjedhore.

Takim pune lidhur me rregullat e informimit deri në fillimin e fushatës zgjedhore



Në kuadër të aktiviteteve në lidhje me monitorimin e Zgjedhjeve lokale 2017, Agjencia organizonte takime pune me televizionet dhe radiot nacionale, temë e të cilës ishin obligimet e radiodifuzerëve në periudhën pas shpalljes së zgjedhjeve e deri në fillim të fushatës zgjedhore.

U potencua se Agjencia në këtë periudhë do të përcjellë respektimin e standardeve të gazetarisë si dhe pluralizmi në përgjithësi, i qëndrimeve dhe pasqyrimeve gjatë informimit, si dhe ndalesat për emetimin e reklamimit të paguar politik, reklamave të financuara nga mjetet buxhetore, njëkohësisht pjesmarrja e redaktorëve, gazetarëve, udhëheqësve dhe prezantuesve të programeve të radios dhe televizionit edhe gjatë aktiviteteve parazgjedhore të partive politike dhe koalicioneve, ndalesës për përdorimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes gjatë informimit.


Raportet dhejtëditore nga monitorimi i informimit mediatic

Për mënyrën e informimit mediatic të radiodifuzerëve, për Zgjedhjet lokale 2017, Agjencia në gusht publikoi dy raporte dhjetëditore nga monitorimi i programit të përgjithshëm të shërbimeve programore të radios dhe televizionit në nivel shtetëror, ku fokusi ishte te informimi i një emisioni ditor informativ në kohën më të shikuar.

Raporti i parë dhjetëditor i agjencisë, që e përfshinte periudhën nga data 7 e deri më 16 gusht 2017, tregoi se radiodifuzerët, në lajmet e tyre, në përgjithësi i respektojnë standardet profesionale të gazetarisë. Te shumica e medimeve vërehet një intencë për të siguruar më shumë qëndrime të ndryshme lidhur me çështjet dhe temat që i përpunojnë. Përgjashtim ishin një numër i madh i medimeve, te të cilat mund të vërehet një tendencë për të transmetuar subjekte që ndajnë të njëjtën pozitë lidhur me tema të caktuara.

Raporti i dytë dhjetëditor nga monitorimi i Agjencisë, për periudhën nga data 17 deri më 26 gusht 2017, tregoi se ka një tendencë të përgjithshme mediatiche të politikave redaktuese që të jenë të hapura për qëndrime të ndryshme në aspekt të ngjarjeve vijuese shoqëro-politike, gjendjeve dhe temave. Me monitorimin është vërejtur se në emisionet qendrore ditore-informative, disa herë, kurse dikund edhe cdo ditë, janë emetuar materiale që kualifikohen si "pseudo ngjarje ose pseudo lajme". Në aspekt të temës "Zgjedhje lokale 2017", materialet e gazetarëve kryesisht kanë të bëjnë me punët organizative në kompetencë të Komisionit shtetëror zgjedhor.

Të gjitha informatat dhe raportet në lidhje me Zgjedhjet lokale mund të merren në ueb faqen e Agjencisë www.avmu.mk, në banerin e posaçëm Zgjedhjet 2017.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup
Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401
e-posta: contact@avmu.mk ueb faqia: www.avmu.mk



MKC EN ISO 9001:2008